



MINISTRI VENUGU: Konferenca e Mynihut, platformë kyçe për avancimin e partneriteteve strategjike

» faqe 3



TIRANË, U MBAJT MINISTERIALI I KORRIDORIT VIII, ZËVENDËSMINISTRJA ABRAZHDA THEKSON RËNDËSINË STRATEGJIKE PËR SIGURINË RAJONALE

Në Tiranë u zhvillua Ministeriali i Korridorit VIII, një takim i nivelit të lartë që mbledhi përfaqësues të vendeve të rajonit dhe partnerë institucionalë për të diskutuar mbi përparimin dhe koordinimin e projekteve që lidhen me këtë korridor strategjik. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe zëvendësm ministrja e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, e cila theksoi se Korridori VIII përbën jo vetëm një projekt të rëndësishëm infrastrukturor...

faqe 2



17 SHKURTI BASHKON UNIFORMAT SHQIPTARE: KMS, AFA DHE QKMBMFA PËRKUJTOJNË PAVARËSINË E KOSOVËS

Me rastin e Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, organizoi një aktivitet përkujtimor dhe kulturor në ambientet e Kinemasë, në garnizonin "Skënderbej". Në këtë veprimtari morën pjesë Ambasadori i Republikës së Kosovës rezident në Tiranë, Skënder Durmishi, drejtues në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, Komandanti...

faqe 5



18 VJET SHTET, FORCA E LIRISË DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË ARDHMEN

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më 17 shkurt 2008, ora 15:39, në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Prishtinë, u lexua Deklarata e Pavarësisë së Kosovës. Në një seancë të jashtëzakonshme me 109 deputetë të pranishëm, Kosova u shpall shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Ky akt ishte kurorëzim i një rrugëtimi të gjatë e të dhimbshëm...

faqe 6

Në Tiranë u zhvillua Ministeriali i Korridorit VIII, një takim i nivelit të lartë që mbledhi përfaqësues të vendeve të rajonit dhe partnerë institucionalë për të diskutuar mbi përparimin dhe koordinimin e projekteve që lidhen me këtë korridor strategjik. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe zëvendësministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, e cila theksoi se Korridori VIII përbën jo vetëm një projekt të rëndësishëm infrastrukturor dhe ekonomik, por edhe një komponent kyç në arkitekturën e sigurisë rajonale.

Sipas saj, zhvillimi i infrastrukturës moderne rrugore, hekurudhore dhe portuale përgjatë këtij korridori forcon ndërlidhjen strategjike mes vendeve të rajonit, rrit ndërveprueshmërinë dhe kontribuon drejtpërdrejt në mobilitetin ushtarak, në përputhje me standardet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Korridori VIII, që lidh Detin Adriatik me Detin e Zi përmes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, konsiderohet një nga projektet më të rëndësishme për integrimin ekonomik dhe sigurinë kolektive në Evropën Juglindore.

Gjatë ministerialit, pjesëmarrësit diskutuan mbi sfidat aktuale të sigurisë në rajon, nevojën për koordinim më të ngushtë ndërinstitutional, si dhe përshtetimin e investimeve strategjike që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe rrisin kapacitetet mbrojtëse.

Zëvendësministria Abrazhda nënvizoi se në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, bashkëpunimi rajonal dhe projektet e përbashkëta infrastrukturorë janë elementë thelbësorë për stabilitetin, zhvillimin dhe rritjen e reziliencës kombëtare.

Ministeriali i Korridorit VIII në Tiranë konfirmoi angazhimin e vendeve pjesëmarrëse për të avancuar këtë projekt strategjik, duke e konsideruar atë si një investim afatgjatë në sigurinë dhe prosperitetin e rajonit.



Tiranë, u mbajt Ministeriali i Korridorit VIII – Zëvendësministria Abrazhda thekson rëndësinë strategjike për sigurinë rajonale



Akademia e Forcave të Armatosura shënon një tjetër arritje të rëndësishme në fushën e arsimit të lartë dhe formimit profesional ushtarak.

Programi i Masterit Profesional “Siguria Kibernetike”, pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, është akredituar me vlerësimin maksimal “Ekselent”, duke përfutur maksimumin e viteve të akreditimit, deri në vitin 2031.

Ky program është i vetmi në Republikën e Shqipërisë që ka marrë vitet maksimale të akreditimit në fushën e sigurisë kibernetike, çka dëshmon për standardet e larta akademike, cilësinë e stafit pedagogjik dhe përputhjen e plotë me kërkesat bashkëkohore të sigurisë kombëtare dhe zhvillimeve teknologjike.

Vlerësimi maksimal përforcon rolin e Akademisë së Forcave të Armatosura si një institucion kyç në ndërtimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Në një kohë kur kërcënimet kibernetike paraqesin sfida gjithnjë e më komplekse për shtetet dhe institucionet, përgatitja e burimeve njerëzore të specializuara mbetet një prioritet strategjik. Masteri “Siguria Kibernetike” synon të formojë ekspertë të aftë për të përballuar sfidat

Masteri “Siguria Kibernetike” në AFA akreditohet me vlerësimin “Ekselent” deri në vitin 2031



e mjedisit digjital, duke kontribuar në forcimin e reziliencës kombëtare dhe në mbrojtjen e infrastrukturave kritike. Ky akreditim konfirmon

angazhimin e AFA-së për cilësi, profesionalizëm dhe përputhje me standardet më të mira në fushën e arsimit të lartë ushtarak dhe civil.

Ministri Vengu: Konferenca e Mynihut, platformë kyçe për avancimin e partneriteteve strategjike

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në **Konferencën e Mynihut për Sigurinë**, i cili është një event vjetor mbi politikën ndërkombëtare të sigurisë që mbahet në Gjermani që nga viti 1963. Në këtë konferencë morën pjesë krerë shtetesh, qeverish dhe organizatash ndërkombëtare, ministra, deputetë, përfaqësues të forcave të armatosura, shkencës, shoqërisë civile, biznesit dhe medias.

Munich Security Conference është cilësuar si një nga ngjarjet më të rëndësishme në nivel global, ku mbledhen zërat më me peshë të sigurisë dhe ku formësohet debati strategjik për çështjet kryesore ndërkombëtare.

Sipas ministrit Vengu, për Shqipërinë kjo konferencë përfaqëson një mundësi konkrete për të avancuar marrëdhëniet me partnerët tradicionalë, si dhe për të çelur rrugë të reja bashkëpunimi me aktorë kyç institucionalë dhe drejtues të kompanive të mëdha, në funksion të sigurisë kombëtare dhe zhvillimit të industrisë ushtarake.

“Konferenca e Sigurisë e Mynihut është padyshim një nga ngjarjet kryesore ku mbledhen zërat më me peshë të sigurisë globale dhe ku formësohet debati strategjik. Për Shqipërinë kjo përfaqëson një mundësi konkrete për të avancuar marrëdhëniet me partnerët tradicionalë dhe për të çelur rrugë të reja bashkëpunimi me aktorë kyç institucionalë dhe drejtues të kompanive të mëdha, në funksion të forcimit të sigurisë kombëtare dhe zhvillimit të industrisë ushtarake”, - u shpreh ministri Vengu.

Ministri thekson se në një Evropë që përballet me një mjedis sigurie gjithnjë e më sfidues, forcimi i partneriteteve dhe koordinimi strategjik mbeten një domosdoshmëri për garantimin e stabilitetit dhe rritjen e kapaciteteve mbrojtëse.

Konferenca e Mynihut për Sigurinë është një event vjetor mbi politikën ndërkombëtare të sigurisë që mbahet në Gjermani që nga viti 1963. Në këtë forum marrin pjesë krerë shtetesh, qeverish dhe organizatash ndërkombëtare, ministra, deputetë, përfaqësues të forcave të armatosura, akademisë, shoqërisë civile, biznesit dhe medias, duke e shndërruar atë në një nga platformat më të rëndësishme globale për dialogun mbi sigurinë dhe mbrojtjen.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë po zhvillojnë stërvitjen paradisllokuese “KFOR 36” në Hohenfels, Gjermani, në kuadër të përgatitjeve për angazhimin e radhës në misionin e KFOR.

Gjatë kësaj stërvitjeje, efektivet e Batalionit Komando janë përfshirë në skenarë të ndryshëm operacionalë, përfshirë marshime taktike, dylufime, patrullime dhe misione vëzhgimi, me synim rritjen e gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë me aleatët.

Stërvitja në Hohenfels, një nga qendrat më të rëndësishme të përgatitjes shumëkombëshe në Gjermani, shërben për testimin e kapaciteteve në kushte sa më pranë realitetit operacional, duke garantuar standarde të larta profesionale për kontingjentin shqiptar.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, duke iu referuar kësaj stërvitjeje, u shpreh se: “Jemi NATO në personel, përgatitje e mbrojtje të sigurisë kolektive”, duke theksuar angazhimin e Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve si vend anëtar i Aleancës.

Stërvitja “KFOR 36” konfirmon përkushtimin e ushtrisë shqiptare për të kontribuar në operacionet e mbështetjes së paqes dhe për të garantuar sigurinë kolektive në rajon dhe më gjerë.



Ushtria shqiptare zhvillon stërvitjen paradisllokuese “KFOR 36” në Hohenfels





Regjimenti i Këmbësoresë së Jugut zhvilloi trajnimin “Fire Phobia” në kuadër të misionit KFOR

Efektivët e Regjimentit të Këmbësoresë së Jugut, të dislokuar në Pejë, Kosovë, zhvilluan trajnimin “Fire Phobia” së bashku me efektivët hungarezë, në kuadër të angazhimeve stërvitore në misionin e KFOR.

Ky trajnim synon rritjen e aftësive operacionale dhe përgatitjen psikofizike të trupave në përballje me situata që përfshijnë përdorimin e zjarrit dhe mjeteve piroteknike, duke forcuar sigurinë dhe reagimin në mjedise komplekse operacionale.

Stërvitja e përbashkët kontribuon në rritjen e ndërveprueshmërisë mes forcave aleate të NATO-s, duke konsoliduar bashkëpunimin shumëkombësh në funksion të operacioneve të mbështetjes së paqes dhe garantimit të stabilitetit në Kosovë.

Pjesëmarrja aktive e kontingjentit shqiptar në këto trajnime dëshmon profesionalizmin, gatishmërinë dhe angazhimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të misionëve ndërkombëtare.



Kontingjenti VII në misionin eVA vijon stërvitjet në Bullgari

Kontingjenti VII në misionin eVA vijon angazhimet stërvitore, duke rritur nivelin e përgatitjes dhe bashkëpunimit me trupat aleate.

Efektivët e Regjimentit të Këmbësoresë së Jugut zhvillojnë stërvitje të përbashkëta me forcat italiane në Bullgari, në kuadër të misionit shumëkombësh. Fokus i veçantë i është kushtuar operacioneve në qendra urbane, lëvizjeve me mjete në fushën e luftimit si dhe organizimit dhe funksionimit të postave të vrojtimit.

Këto aktivitete synojnë rritjen e gatishmërisë operacionale dhe forcimin e ndërveprueshmërisë mes trupave aleate, duke garantuar përmbushjen me profesionalizëm të detyrave në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare.

Stërvitjet e përbashkëta dëshmojnë përkushtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të kontribuar në sigurinë kolektive dhe për të ruajtur standardet më të larta të përgatitjes ushtarake.

Forca Tokësore zhvilloi veprimtari sportive në kuadër të Ditës së CISM

Në kuadër të Ditës së themelimit të Conseil International du Sport Militaire (CISM), Forca Tokësore organizoi veprimtari sportive në të gjitha njësitë e saj, nga veriu në jug të vendit.

Aktivitetet përfshinë gara sportive dhe ushtrime fizike, të cilat vunë në pah unitetin, disiplinën, sakrificën dhe frymën e garës së ndershme që karakterizon çdo ushtarak. Përmes këtyre veprimtarive, personeli i Forcës Tokësore dëshmoi nivel të lartë përgatitjeje fizike dhe angazhim profesional.

Dita e CISM shërben jo vetëm si moment për të promovuar sportin ushtarak, por edhe si një mundësi për të forcuar kohezionin dhe solidaritetin brenda radhëve të Forcave të Armatosura.

Këto aktivitete përbëjnë një dëshmi konkrete të përkushtimit, gatishmërisë dhe shpirtit të bashkëpunimit që karakterizon Forcën Tokësore në përmbushjen e çdo misioni dhe sfide.



KMS i bashkohet nismës “Dhuro gjak, shpëto jetë”

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë iu bashkua nismës humanitare “Dhuro gjak, shpëto jetë”, duke kontribuar në mënyrë aktive në mbështetje të nevojave të sistemit shëndetësor dhe komunitetit.

Në kuadër të kësaj nisme, stafi akademik dhe kursantët e kurseve të Kolegjit iu përgjigjën thirrjes së Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut për dhurim vullnetar të gjakut. Komanda e Kurseve, në bashkëpunim me degën e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak, Protokollit dhe Medias, koordinoi masat me Drejtorinë e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në SHPFA për sensibilizimin e personelit akademik dhe kursantëve. Dhurimi u realizua mbi bazë vullnetare, në një atmosferë solidariteti dhe përgjegjësie qytetare. Ky akt humanitar përbën një kontribut të drejtpërdrejtë në shpëtimin e jetëve dhe dëshmon angazhimin e personelit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë jo vetëm në përmbushjen e misionëve akademike e profesionale, por edhe në shërbim të komunitetit.

Përmes kësaj aktiviteti, KMS riafirmon rolin e tij si institucion që promovon vlerat e humanizmit, solidaritetit dhe përkushtimit ndaj shoqërisë.



17 SHKURTI bashkon uniformat shqiptare: KMS, AFA dhe QKMBMFA përkujtojnë Pavarësinë e Kosovës

Me rastin e Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, organizoi një aktivitet përkujtimor dhe kulturor në ambientet e Kinemasë, në garnizonin “Skënderbej”.

Në këtë veprimtari morën pjesë Ambasadori i Republikës së Kosovës rezident në Tiranë, Skënder Durmishi, drejtues në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, Komandanti i Akademisë së FA-së gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, staf akademik si dhe kursantë nga Shqipëria dhe Kosova.

Mesazhe uniteti dhe bashkëpunimi

Aktiviteti u çel me fjalën përshëndetëse të Komandantit të KMS-së, gjeneral brigade Altin Kurti, i cili theksoi rëndësinë e 17 Shkurtit si simbol i lirisë dhe shtet formimit të Kosovës, duke nënvizuar rolin në rritje të Forcës së Sigurisë së Kosovës si partnere e besueshme e NATO-s.

“Sot Kosova nuk feston vetëm me flamuj, por me një Forcë Sigurie që po shndërrohet dita-ditës në një ushtri moderne. Prania e studentëve nga Shqipëria dhe Kosova është dëshmi se ëndrra e vitit 2008 është sot realitet. Uniforma që mbani ka peshën e historisë dhe shpresën e gjeneratave”, u shpreh ai, duke i ftuar kursantët të forcojnë miqësitë dhe bashkëpunimin profesional, si garanci për të ardhmen.

Në vijim, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, theksoi se Pavarësia e Kosovës është “fitore e shpirtit të pathyeshëm shqiptar” dhe fryt i sakrificave të brezave që besuan në lirinë si vlerë të panegociueshme. Ai nënvizoi se ekzistenca kombëtare mbetet përgjegjësi e përbashkët dhe një amanet që duhet mbrojtur çdo ditë.



Përshëndetja e Ambasadorit të Kosovës

Në fjalën e tij, Ambasadori i Republikës së Kosovës, Skënder Durmishi, falënderoi organizatorët për realizimin e aktivitetit kulturor-artistik, duke e cilësuar atë si dëshmi të respektit dhe përkushtimit ndaj vlerave të lirisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Ai ndau me të pranishmit reflektime nga rrugëtimi historik i Kosovës drejt shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, në Prishtinë, duke theksuar se kjo datë mbetet një moment themelor që forcon besimin

në demokraci, paqe dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Aktiviteti vijoi me shfaqjen e materialit filmik “Gjurmë, rezistenca, çlirimi dhe Pavarësia”, si dhe me pjesë muzikore të interpretuara nga kursantë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Veprimtaria u mbyll me një koncert të organizuar nga Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura.

Kjo veprimtari konfirmoi edhe një herë lidhjet e forta institucionale dhe vëllazërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe formimit profesional të brezit të ri të oficerëve.



18 Vjet Shtet, Forca e Lirisë dhe Përgjegjësia për të Ardhmen

17 Shkurti, Dita që Ndryshoi Historinë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më 17 shkurt 2008, ora 15:39, në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Prishtinë, u lexua Deklarata e Pavarësisë së Kosovës. Në një seancë të jashtëzakonshme me 109 deputetë të pranishëm, Kosova u shpall shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Ky akt ishte kurorëzim i një rrugëtimi të gjatë e të dhimbshëm, i mbushur me sakrifica, rezistencë dhe shpresë.

Pavarësia e Kosovës nuk ishte vetëm një akt juridik; ishte një akt historik, moral dhe politik. Ajo përfaqësonte përmbushjen e aspiratës shekullore për liri dhe vetëvendosje. Ishte momenti kur një popull, pas dekadash shtypjeje dhe spastrimi etnik nga regjimi i Sllobodan Millosheviq, shpalli para botës të drejtën për të jetuar i lirë në tokën e vet.


Në atë ditë historike, ndër të parët që nënshkruan Deklaratën ishin presidenti Fatmir Sejdiu, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi dhe kryeministri Hashim Thaçi. Himni shtetëror, i kompozuar nga Mendi Mengjiçi, u intonua për herë të parë, duke shënuar lindjen e një epoke të re.

Nga Lufta në Shtetndërtim - Rruga e Vështirë e Kosovës

Para se të vinte 17 shkurti, Kosova kaloi nëpër një periudhë të errët. Deri në qershor 1999, qytetarët e Kosovës përjetuan dhunë sistematike, dëbime masive dhe shkatërrim. Pas ndërhyrjes ndërkombëtare dhe largimit të forcave serbe më 13 qershor 1999, Kosova u administrua nga misioni i UNMIK, nën mandatin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në nëntor 2005 nisi zyrtarisht procesi për statusin përfundimtar të Kosovës. Ishte një periudhë intensive diplomatike, me përfshirjen e faktorit ndërkombëtar dhe me përkushtimin e udhëheqjes vendore për të ndërtuar institucione funksionale, demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Shpallja e Pavarësisë nuk ishte fundi i rrugës, ishte fillimi i një faze të re: ndërtimi i shtetit. Kosova filloi të ndërtojë ushtrinë e saj, policinë, sistemin gjyqësor, administratën publike dhe mekanizmat demokratikë. Njohjet ndërkombëtare nga shtete si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca, Shqipëria, Turqia dhe shumë të tjera forcuan legjitimitetin ndërkombëtar të shtetit të ri.



Ligjshmëria Ndërkombëtare - Vula e Drejtësisë

Serbia kundërshtoi shpalljen e pavarësisë dhe kërkoi opinion këshillues nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Më 22 korrik 2010, kjo gjykatë dha një vendim historik: Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk kishte shkelur asnjë normë të së drejtës ndërkombëtare.

Ky vendim ishte një moment i rëndësishëm për Kosovën, duke i dhënë fund debatit juridik mbi ligjshmërinë e aktit të 17 shkurtit. Ai përforcoi pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe konfirmoi se aspirata për liri ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Për ushtrinë dhe institucionet e sigurisë së Kosovës, ky vendim përbën një themel të fortë ligjor mbi të cilin ndërtohet misioni

për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial.

Simbolet e Shtetit, Identiteti i Republikës

Flamuri dhe stema e Kosovës, të dizajnuara nga Muhamer Ibrahim, përfaqësojnë unitetin dhe diversitetin e vendit. Yjet e bardhë simbolizojnë komunitetet që jetojnë në Kosovë, harta e artë pasurinë dhe territorin, ndërsa sfondi blu orientimin evropian të shtetit. Pergamena 200-vjeçare ku është nënshkruar Deklarata e Pavarësisë ruhet në zyrën e kryetarit të Kuvendit – një relike historike që simbolizon aktin më të rëndësishëm politik në historinë moderne të Kosovës. Këto simbole nuk janë vetëm elemente vizuale; ato janë dëshmi e sakrificës së brezave dhe përgjegjësi për brezat që vijnë.

Ushtria, Garancia e Sovranitetit dhe Paqes

Në 18-vjetorin e Pavarësisë, roli i ushtrisë dhe institucioneve të sigurisë është më i rëndësishëm se kurrë. Ushtria e Kosovës nuk është thjesht forcë mbrojtëse; ajo është simbol i shtetësisë, profesionalizmit dhe partneritetit ndërkombëtar.

Nga një vend i dalë nga lufta, Kosova është shndërruar në faktor stabiliteti në rajon. Përmes bashkëpunimit me aleatët strategjikë dhe përkushtimit ndaj standardeve euroatlantike, ushtria përfaqëson garantin e sovranitetit dhe sigurisë kombëtare.

Ndërsa flamujt valëviten nëpër sheshe dhe institucionet shënojnë këtë përvjetor me aktivitete festive, kujtojmë se liria nuk është e përhershme pa përkushtim. Pavarësia është përgjegjësi. Shteti është detyrë. Në këtë 18-vjetor, le të riafirmojmë zotimin tonë për një Kosovë të fortë, demokratike dhe të sigurt, një shtet me zemër të madhe, i ndërtuar mbi sakrificë, i mbrojtur me nder dhe i orientuar drejt së ardhmes.

I përjetshëm në memorien e Forcave të Armatosura

20 shkurti: Dita e kujtesës dhe krenarisë

Prej 14 vitesh, 20 shkurti mbledh ushtarakët shqiptarë në një përkujtim solemn, ku dhimbja dhe krenaria bashkëjetojnë në heshtje. Është dita kur Forcat e Armatosura përkulen me nderim para kujtimit të Kapiten Feti Vogli, i rënë në krye të detyrës, më 20 shkurt 2012, gjatë një misioni ushtarak në Afganistan.

Ai u nda nga jeta në shërbim të paqes, gjatë një detyre të marrë nga komanda amerikane për të shoqëruar një zyrtar të Shteteve të Bashkuara në një shkollë dhe në një spital në Afganistan. Në përmbushje të këtij misioni, kolona ushtarake u sulmua nga një taleban, i cili hapi zjarr me mitraloz në drejtim të efektivëve shqiptarë. Plumbat goditën kapitenin Voglin, i cili nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra.

Në të njëjtin sulm mbeti i plagosur rëndë edhe ushtari **Aleksandër Peçi**, duke dëshmuar edhe një herë rrezikun e përhershëm që shoqëron misionet ndërkombëtare të paqes.

Rënia e kapiten Voglit shënoi një moment të dhimbshëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por njëkohësisht një kapitull nderi në historinë e tyre.

Rrugëtimi në FA i kapiten Feti Voglit

Kapiten Feti Vogli lindi, më 23 maj 1981, në fshatin Baldushk, rrethi i Tiranës. Që në rininë e hershme u dallua për karakterin e fortë, disiplinën dhe përkushtimin ndaj uniformës.

Pas përfundimit të Akademisë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore, ai u bë pjesë e Forcave të Armatosura me detyrën e komandantit të togës në Brigadën e Stërvitjes së Bazës, Bunavi.

Bruga e tij profesionale mori një drejtim të qartë më 16 korrik 2005, kur pas përfundimit me sukses të Kursit Bazë të Forcave Speciale, iu bashkua Batalionit të Forcave Speciale me detyrën e Komandantit të Grupit.

Që nga 1 qershori 2010, kapiten Vogli kryente detyrën e Komandantit të Grupit të Parë Special në Kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore, një nga strukturat më elitare të Forcave Speciale shqiptare.

Kolegët e tij e përshkruajnë si një ushtarak karriere të shkëlqyer, kërkues ndaj vetes, të vendosur në detyrë dhe të përkushtuar ndaj vartësve. Ai ishte një komandant që udhëhiqte me shembull personal, duke qenë gjithmonë në vijën e parë.

Medaljet e një karriere të ndritur

Për arritjet dhe profesionalizmin e treguar në detyrë, kapiten Feti Vogli ishte dekoruar disa herë:

- **Medalja e Karrierës (2007) nga Komandanti i Forcës së Bashkuar;**
- **Medalja për Shërbime Ndërkombëtare (2007) nga Ministri i Mbrojtjes;**
- **Medalja për Shërbime të Shquara (2010) nga Ministri i Mbrojtjes.**

Këto vlerësime nuk ishin thjesht simbole ceremoniale, por dëshmi e një rruge të ndërtuar mbi disiplinë, sakrificë



Heronjve u këndohen veç këngë

*“Shqipet mbjellin paqe në çdo prag,
Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmijë
Feti Vogli mbjell lule Shqipërie,
Skënderbegas të rriti ushtria,
Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia.
O pishtar me dritë lirie,
Feti Vogli prej Shqipërie.”*



KAPITEN FETI VOGLI



dhe përkushtim ndaj misionit.

Misioni “Eagle 4”, një kapitull krenarie

Misioni “Eagle 4” i Forcave Speciale shqiptare në Afganistan mbetet një nga angazhimet më të rëndësishme dhe më të kujtuara të kontingjentit shqiptar në operacionet ndërkombëtare.

Pjesëtarët e Forcave Speciale që shërbyen në këtë mision e kujtojnë me krenari profesionalizmin dhe bashkëpunimin me partnerët strategjikë, si dhe nivelin e lartë të përgatitjes së efektivëve shqiptarë.

Edhe përfaqësues të lartë të shtetit dhe ushtarakë amerikanë kanë vlerësuar kontributin e Forcave Speciale shqiptare në operacionet e sigurisë dhe stabilizimit.

Në këtë mision, kapiten Feti Vogli nuk ishte thjesht një pjesëmarrës, ai ishte një komandant që mishëronte frymën e sakrificës dhe të detyrës deri në fund.

Dëshmori i Atdheut, një figurë që bashkon

Figura e kapiten Feti Voglit nderohet jo vetëm nga personeli i Forcave Speciale, por nga të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Veprat sublime të atyre që bien për idealet e larta të lirisë nuk harrohen. Ato jetojnë në memorien institucionale, në ceremonitë përkujtimore dhe në edukimin e brezave të rinj ushtarakë.

Kapiten Feti Vogli është shpallur Dëshmor i Atdheut – një titull që përmbledh jo vetëm aktin e rënies në detyrë, por edhe jetën e jetuar me nder.

Çdo 20 shkurt, në ambientet ushtarake, në

përkujtimore dhe homazhe, rikthehet kujtimi i tij. Emri i tij përmendet me respekt. Historia e tij u tregohet kursantëve dhe ushtarëve të rinj si model i përkushtimit maksimal ndaj flamurit dhe atdheut.

Sakrifica që nuk shuhet me kohën

Rënia e kapiten Feti Voglit në Afganistan nuk ishte vetëm një humbje për familjen dhe kolegët, por një plagë për gjithë Forcat e Armatosura. Megjithatë, nga kjo plagë lindi edhe një simbol.

Simboli i ushtarakut që përmbush misionin pa u tërhequr. Simboli i komandantit që qëndron në krye. Simboli i shqiptarit që shërben për paqen globale. Sakrifica e tij është pjesë e kontributit të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare dhe në përpjekjet për siguri e stabilitet në botë.

Lavdi e përjetshme

E paharruar do të mbetet vepra e Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, i rënë në krye të detyrës, më 20 shkurt 2012, në Afganistan.

Në memorien e Forcave të Armatosura ai mbetet një emër që frymëzon, një histori që edukon dhe një shembull që orienton brezat e rinj.

Heronjve u këndohen këngë. Dëshmorëve u përkulen flamujt. Ndërsa emrat e tyre shkruhen me germa të arta në historinë e kombit.

Lavdi dhe mirënjohje të përjetshme për sakrificën sublime të kapiten Feti Voglit dhe për të gjithë Dëshmorët e Atdheut që ranë në krye të detyrës, në shërbim të paqes, lirisë dhe nderit të Shqipërisë.

INDRIT CARA - “USHTAR KAVAJA”

NJË EMËR QË U BË SIMBOL I LIRISË

Ai lindi në Kavajë, por sot i përket mbarë shqiptarisë. Jeta dhe rënia e **Indrit Carës** nuk janë thjesht një histori personale, por një kapitull i gjallë i kujtesës sonë kombëtare. I njohur me nofkën “Ushtar Kavaja”, ai mbetet një figurë frymëzuese e guximit, përkushtimit dhe dashurisë për atdheun.

Në moshën 28-vjeçare, ai zgjodhi rrugën më të vështirë: t'i bashkohej radhëve të **Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**, në kulmin e luftës për liri. Vendimi i tij ishte i qartë, i ndërgjegjshëm dhe pa kthim pas.

NGA KAVAJA NË FRONTIN E LUFTËS

Pas disa vitesh jetese në Angli, ku kishte ndërtuar një jetë të qetë dhe të qëndrueshme, Indriti u kthye, më 26 janar 1999, në shtëpinë e tij në Kavajë. Punonte, ndihmonte familjen dhe kishte krijuar stabilitet. Por brenda tij digjej një thirrje tjetër.

Atë mbrëmje janari, ai trokiti papritur në derën e prindërve. Malli ishte i madh. Qëndroi gjatë me ta, bisedoi, kujtoi kohët e fëmijërisë. Fotografitë e asaj nate tregojnë një djalë të qeshur, por me një vendim të prerë në zemër.

Të nesërmen në mëngjes, ai u tha prindërve se do të shoqëronte dy gazetarë britanikë. Ishte një justifikim për të mos i shqetësuar. E vërteta ishte ndryshe: kishte vendosur të hynte në luftë.

Më 27 janar 1999, ai përqafoi për herë të fundit nënën dhe babanë. U largua me premtimin se do të kthehej shpejt. Nga Tirana drejt Kukësit, e më pas drejt vijës së zjarrit.

NË MBROJTJE TË PASHTRIKUT

Indriti u vendos në vijën e parë të përballjes. Qëndroi i palëkundur në betejat e ashpra të marsit 1999. Më 31 mars, gjatë luftimeve intensive në zonën e Pashtrikut, mori detyrën për të rimarrë dhe mbrojtur majën e malit të Gallushës, në mbrojtje të mijëra civilëve.



të Kombit dhe Atdheut”. Bulevardi kryesor i qytetit dhe shkolla ku ai mësoi mbajnë sot emrin e tij.

NË TRADITËN E HERONJVE

Figura e Indrit Carës vendoset në një vijë historike që përfshin emra si **Adem Jashari**, **Ibrahim Rugova**, **Adem Demaçi** e shumë të tjerë që i dhanë formë përpjekjes për liri.

Në vargjet që i atribuohen “Ushtar Kavajës” ndihet fryma e kësaj trashëgimie:

“Tungjatjeta vëllezër, djemtë e Dardanisë Jam Ushtar Kavaja, balli i trimërisë Vëllai i Adem Jasharit, nip i Skënderbeut Vetë do t'ia qepim hartën atdheut.”

Këto rreshta nuk janë thjesht poezi; janë deklaratë identiteti dhe besimi.

DY SHTETE, NJË KOMB

Sot Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete të pavarura, por lidhja kombëtare mbetet e pandashme. Sakrifika e Indrit Carës shërben si kujtesë se liria nuk erdhi rastësisht. Ajo u fitua me mund, gjak dhe vendosmëri.

Identiteti shqiptar, i trashëguar ndër shekuj, kërkon ruajtje dhe përkushtim. Ai nuk është vetëm çështje historie, por përgjegjësi e përditshme.

NJË BUSULL PËR BREZAT

Historia e tij flet për integritet, kurajë dhe vendosje të interesit kombëtar mbi atë personal. Ai la pas një jetë të sigurt për t'iu përgjigjur një ideali.

Për brezat që vijnë, shembulli i tij mbetet udhërrëfyes: një komb forcohet kur bijtë dhe bijat e tij veprojnë me ndershmëri, unitet dhe përgjegjësi.



Puthja e fundit e nënës



Misioni u realizua. Por një goditje nga minahedhësi i mori jetën. Në moshën 28-vjeçare, “Ushtar Kavaja” ra në fushëbetejë. Rënia e tij nuk ishte fundi, por fillimi i përjetësisë në kujtesën e kombit.

NJË EMËR QË U KTHYE NË PËRJETËSI

Në tetor 1999, eshtrat e tij u kthyen në vendlindje. Kavaja e priti me dhimbje dhe krenari. Ai nuk u kthye më si djalë, por si simbol.

Për veprën e tij, Presidenti i Republikës së Shqipërisë e dekoroi me “Shqiponjën e Artë”, ndërsa Presidentja e Kosovës e nderoi me titullin “Hero i Kosovës”. Institucionet vendore e shpallën “Dëshmor

Integrimi në strukturat euroatlantike, zhvillimi dhe paqja janë aspirata që ndërtohen mbi themelet e sakrificave të tilla.

KUJTIM QË NUK SHUHET

Indrit Cara nuk është vetëm një emër në pllaka përkujtimore. Ai është pjesë e ndërgjegjes sonë kolektive. Kujtimi i tij jeton në zemrat e shqiptarëve, si një dritë që nuk zbehet.

Lavdi Dëshmorit të Kombit, Indrit Cara!
Lavdi të gjithë atyre që sakrifkuan për lirinë!
Lavdi qytetarisë së Kavajës!

MOS JI NJË LIBËR I HAPUR PËR KËDO

Arti i ruajtjes së vetes në një botë që lexon pa mirësi

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një shoqëri ku ekspozimi është kthyer në normë dhe transparenca shpesh ngatërrohet me cenueshmërinë e pakushtëzuar, ruajtja e vetes nuk është mbyllje, është vetëdije.

KULTURA E EKSPOZIMIT: NGA DITARI TEK RRJETET SOCIALE

Dikur, ditarët mbanin sekrete. Sot, rrëfimet personale publikohen në platforma ku gjithçka komentohet, gjykohet dhe shpesh keqinterpretohet. Çdo emocion, çdo zhgënjim, çdo arritje shpërndalet menjëherë.

Por jo të gjithë lexojnë me të njëjtin sy. Disa i zhvlerësojnë përjetimet e tua. Disa i shtrembërojnë sipas interesit të tyre. Disa i përdorin kundër teje. Dhe ka edhe nga ata që thjesht nuk dinë të lexojnë ndjenjat.

Psikologët theksojnë se kufijtë emocionalë janë thelbësorë për shëndetin mendor. Hapja është e shëndetshme por vetëm në mjedise të sigurta.

NDËRMJET SINQERITETIT DHE NAAVITETIT

Të jesh i singertë nuk do të thotë të jesh i pambrojtur. Të ndash përvojat nuk do të thotë të zbrazësh gjithë shpirtin para kujt.

Ekziston një vijë e hollë mes autenticitetit dhe ekspozimit të tepruar. Shpesh, njerëzit që hapen pa filtra e bëjnë këtë nga nevoja për t'u kuptuar. Por kuptimi kërkon përgatitje edhe nga pala tjetër.

Jo çdo dëgjues është i aftë të mbajë peshën e rrëfimit tënd.

KUR FJALËT KTHEHEN NË ARMË

Historia njerëzore është e mbushur me raste kur informacioni personal është përdorur si mjet manipulimi. Në marrëdhënie toksike, në ambiente pune konkurruese apo në rrethe shoqërore të pasigurta, sinqeriteti i pakontrolluar mund të kthehet në dobësi të perceptuar.

Të ruash disa kapituj të jetës nuk është mungesë besimi, është zgjedhje për të mos i dorëzuar armë kujt që mund të mos dijë t'i përdorë me përgjegjësi.

MISTERI SI DINJITET

Shprehja "Bëhu një mister i brishtë" nuk flet për lojë apo manipulim. Ajo flet për dinjitet.

Një njeri që nuk i shpalos menjëherë të gjitha dimensionet e veta krijon hapësirë për respekt. Misteri nuk është fshehje, është ritëm. Është e drejta për të zgjedhur kohën, vendin dhe personin me të cilin ndan thellësitë e tua.

Respekti lind kur dikush e kupton se jo çdo faqe mund të hapet me nxitim.

KUFIRI SI AKT VETËRESPEKTI

Vendosja e kufijve është një aftësi që mësohet.

Ajo fillon me disa pyetje të thjeshta: A ndihem i sigurt me këtë person? A ka treguar ai/ajo ndjeshmëri ndaj të tjerëve? A e respekton konfidencialitetin?

Nëse përgjigjet janë të paqarta, ndoshta është më mirë të ndash vetëm kapitujt e parë.

Kufijtë nuk i largojnë njerëzit e duhur. Ata filtrojnë ata që nuk janë gati për thellësinë tënde.

"Gabimi më i madh që mund të bësh është të jesh një libër i hapur për këdo." Kjo fjali, që qarkullon shpesh në rrjete sociale e biseda të përditshme, në thelb ngre një pyetje të thellë: sa duhet të ndajmë nga vetja në një botë që jo gjithmonë lexon me dashamirësi?



PSE NDJEJMË NEVOJËN TË HAPEMI?

Në thelb, çdo njeri kërkon të shihet dhe të kuptohet. Kjo është nevojë themelore njerëzore. Por kuptimi i vërtetë nuk vjen nga sasia e informacionit të ndarë; vjen nga cilësia e lidhjes.

Një bisedë e thellë me një mik të besuar vlen më shumë se dhjetëra rrëfime publike pa përgjigje të ndjeshme.

LIBRI I ZEMRËS: KUJDESI NDAJ VETES

Metafora e librit është e fuqishme. Secili prej nesh ka kapituj drite dhe kapituj errësire. Ka faqe krenarie dhe faqe dhimbjeje. Por jo çdo lexues është i përgatitur për të kuptuar kontekstin. Disa lexojnë për të mësuar. Disa lexojnë për të gjykuar. Disa lexojnë për të krahasuar. Disa lexojnë vetëm për të gjetur gabime. Prandaj kujdesi ndaj vetes është thelbësor. Të zgjedhësh kujt ia hap librin e zemrës është një akt maturie.

EDUKIMI EMOCIONAL, NJË NEVOJË E KOHËS

Në sistemin tonë arsimor flitet pak për kufijtë emocionalë. Fëmijët mësojnë lëndë shkencore, por jo gjithmonë mësojnë si të mbrojnë intimitetin e tyre emocional.

Ndërgjegjësimi për këtë temë duhet të fillojë herët: Të rinjtë duhet të mësojnë se jo çdo informacion personal duhet shpërndarë online. Të kuptojnë se

privatësia është pasuri, jo pengesë. Të dallojnë mes miqësisë së vërtetë dhe kuriozitetit sipërfaqësor.

Shoqëria moderne shpesh shpërblen ekspozimin. Sa më shumë rrëfen, aq më shumë vëmendje merr. Por vëmendja nuk është gjithmonë vlerësim.

Të jesh selektiv në ndarjen e jetës tënde nuk do të thotë të jesh i ftohtë. Do të thotë të jesh i ndërgjegjshëm për vlerën e historisë tënde.

Jo çdo auditor është publik për autobiografinë tënde.

Titulli që ngjall respekt

Në fund, çdo njeri është autor i vetes. Mund të zgjedhësh të jesh një broshurë e shpërndarë pa kriter, ose një vepër që lexohet me kujdes.

Një titull që ngjall respekt nuk krijohet nga mister i rremë, por nga karakteri. Nga qëndrueshmëria. Nga integriteti.

Kur je i plotë me veten, nuk ke nevojë të zbrazësh para kujt për t'u ndjerë i vlefshëm.

HAPJA ME MASË, JO ME FRIKË

Mesazhi nuk është të mbyllemi. Nuk është të ndërtojmë mure të pakalueshme. Është të ndërtojmë porta dhe të vendosim vetë kur dhe për kë hapen.

Sepse libri i zemrës është i çmuar. Dhe jo të gjithë dinë ta lexojnë me dashamirësi. Bëhu i vërtetë. Bëhu i thellë.

Por mbi të gjitha, ruaje veten.

Një studim i kohës: “Lufta për Vlorën – 1920”



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Piketat e studimit

Studimi **“Lufta për Vlorën – 1920”**, me përmbajtje të thellë gjeopolitike, diplomatike, strategjike dhe të artit ushtarak, vjen nga studiuesi i njohur ushtarak Zeno Jahaj. Vepra është një analizë e mirëfilltë shkencore dhe përbën literaturë të vlefshme ndihmëse për përgatitjen e studentëve ushtarakë, veçanërisht në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Që në hyrje, autori sjell një thënie domethënëse: *“Kush zotëron Vlorën, hyn në syrin e Fuqive të Mëdha”*, duke e vendosur menjëherë lexuesin në dimensionin gjeostrategjik të çështjes. Libri hapet me një parathënie nga studiuesi ushtarak Agron Berdaj, i cili vlerëson rëndësinë historike të kësaj lufte dhe vazhdimësinë e studimeve mbi të ndër vite.

Një nga çështjet që autori trajton që në fillim është emërtimi: pse “Lufta për Vlorën” dhe jo “Lufta e Vlorës”? Përgjigjja e tij është e qartë: sepse kjo luftë lindi dhe u zhvillua në një terren të gjerë gjeopolitik e strategjik, jo thjesht si një përplasje lokale territoriale.

Në sfondin e dinamikave të Lufta e Parë Botërore, ku përplaseshin interesat e Fuqive të Mëdha të Evropës dhe të Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia shfaqet si një aktor me ambicie të qarta mbi Shqipërinë dhe veçanërisht mbi Vlorën.

Në kapitullin “Diplomacia”, autori i referohet mendimit të Henry Kissinger mbi dështimet strategjike të Luftës së Parë Botërore dhe pasojat e tyre në proceset e paqes. Më tej trajtohet Konferenca e Paqes e Parisit, ku Shqipëria mbeti jashtë tryezës vendimmarrëse, duke u përballur me rrezikun e copëtimit.

Studimi vijon me analizën e dinamikave strategjike në Ballkan, në Shqipëri dhe në Vlorë, duke ndalur veçanërisht në rolin e Kongresi i Lushnjës dhe pozicionin gjeostrategjik të qytetit të Vlorës.

Në kapitullin “Arti i Luftës për Vlorën”, autori analizon planifikimin politik e ushtarak italian, organizimin e forcave vullnetare shqiptare, si dhe zhvillimin e veprimeve ushtarake, politike e diplomatike gjatë konfliktit. Një syth i veçantë i kushtohet “Kartës” së Ishullit të Sazanit dhe rolit të tij strategjik.

